



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P- 94
Prishtinë, më 29 dhjetor 2009

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 DHJETOR 2009**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetari i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 83 deputetë.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2009, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, nuk ka pasur asnjë kërkesë me shkrim për plotësimin e rendit të ditës.

Kryeari i Grupit parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, propozoi që pika e dytë e rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, të hiqet nga rendi i ditës, me arsyetimin se materialet për këtë pikë u janë dërguar deputetëve me vonesë dhe nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'i shqyrtuar.

Kryetari tha se në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, ku ishin të pranishëm edhe kryetarët e grupeve parlamentare, rendi i ditës për seancën e sotme njëzëri është përcaktuar dhe u është dërguar të gjithë deputetëve.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 18 dhjetor 2009,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në vlerën e shtuar,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për borxhet publike,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër korrupsionit dhe
9. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për vazhdimin e afatit shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 18 dhjetor 2009

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 18 dhjetor 2009.

Deputetja **Mimoza Ahmetaj** pati vërejtje në transkriptin e seancës së fundit, faqe 34, që është korrigjuar sipas vërejtjes së saj.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta marrë fjalën.

Gani Koci falënderoi të gjithë anëtarët e Komisionit që ai e udhëheq, për punën dhe propozimet e bëra, të cilat janë miratuar në Komision në mënyrë unanime.

Në vijim, ai tha se amendamentet e Komisionit nuk kanë qenë shumë të ndryshme për faktin e mundësive të kufizuara buxhetore dhe se orientimi i këtij komisioni ka qenë i tillë që t'i jepet prioritet një shpërndarje sa më të drejtë buxhetore.

Kryetari hodhi në votim amendamentet një nga një.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39.

Në vijim, **Kryetari** i njoftoi deputetët se do të votojnë veç e veç për buxhetin e institucioneve të pavarura.

Kuvendi miratoi buxhetin e këtyre institucioneve të pavarura: të Gjykatës Kushtetuese, të Zyrës Rregullative për Energji, të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të Komisionit Qendror Zgjedhor, të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, të Institucionit të Avokatit të Popullit, të Komisionit për Ndihmë Juridike dhe të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----66,
Kundër-----4,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në vlerën e shtuar

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ose raportuesin e komisionit që ta marrë fjalën.

Gani Koci tha se sot i kemi pesë projektligje që e përbëjnë pakon e projektligjeve që kanë të bëjnë me fushën financiare dhe fiskale, për të cilat nuk do të flas gjatë, por për këtë Projektligj për çdo sqarim do të jetë z. Armend Zemaj ai që do të japë përgjigje në pyetjet eventuale.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41 dhe 42.

Kryesuesi hodhi në votim projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----23,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për tatimin në vlerën e shtuar.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ose raportuesin e komisionit që ta marrë fjalën.

Pasi as nga komisioni funksional, as nga deputetët e tjerë nuk pati të paraqitur për diskutim, **Kryesuesi** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Kryesuesi hodhi në votim projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër-----12,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ose raportuesin e komisionit që ta marrë fjalën.

Pasi as nga komisioni funksional, as nga deputetët e tjerë nuk pati të paraqitur për diskutim, **Kryesuesi** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, dhe 45.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----52,
Kundër-----14,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për tatimin në të ardhurat personale.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, pastaj Kryetarin e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ose raportuesin e komisionit që ta marrë fjalën.

Pasi as nga komisioni funksional, as nga deputetët e tjerë nuk pati të paraqitur për diskutim, **Kryesuesi** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,
Kundër-----5,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për borxhet publike

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ose raportuesin e komisionit që ta marrë fjalën.

Pasi as nga komisioni funksional, as nga deputetët e tjerë nuk pati të paraqitur për diskutim, **Kryesuesi** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,
Kundër-----5,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për borxhet publike.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër korrupsionit

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi ose raportuesin e komisionit që ta marrë fjalën.

Pasi as nga komisioni funksional, as nga deputetët e tjerë nuk pati të paraqitur për diskutim, **Kryesuesi** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër-----1,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin kundër korrupsionit.

10. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për vazhdimin e afatit shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Kryetari për këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia dha kryetarit të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Rrustem Mustafa tha se komisioni, me miratimin unanim të anëtarëve, ka vlerësuar se në këtë projektligj nevojitet një punë më e thelluar për të bërë amendamentimet çfarë duhet të jenë, andaj për këtë arsye ka kërkuar një afat shtesë, ashtu siç e kemi paraqitur në kërkesë.

Kryetari kërkoi nga deputetët të deklarohen me ngritje dore nëse pajtohen për afatin shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri i vazhdohet afati për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale deri në fund të janarit 2010.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 13:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale**